Simulimi përdoret shpesh si një strategji në njësitë e kurrikulit të filmit dhe mediave. Siç është përmendur tashmë, tutorët përdorin simulimin për t'iu demonstruar studentëve se 'si duket' edukimi mbi median. Pra, tutori merr rolin e mësuesit në klasë dhe mësuesit veprojnë si nxënës të moshës shkollore, të paktën kur bëjnë aktivitetet. Kjo strategji diskutohet pastaj me studentët si një proces pedagogjik.

Simulimi mund të përdoret në këto mënyra:

- Studentët e marrin rolin e një ekipi xhirues të dokumentarëve duke e bërë një dokumentar për një program televiziv për të rinjtë
- Studentët marrin rolin e gazetarëve të radios ose të internetit të cilët po hetojnë mësimin e medias dhe u kërkohet të intervistojnë një mësues të medias dhe të modifikojnë një podcast nga intervista
- Studentët marrin rolin e një ekipi marketing nga universiteti duke e bërë një video të shkurtë prezantimi për studentët e ardhshëm për jetën në universitet

## PRODHIMI

Kjo qasje përfshin mësimin duke bërë, gjë që është një aspekt i rëndësishëm i përvetësimit të njohurive në shekullin e njëzetë. Nxënësit duhet të inkurajohen që të eksplorojnë të nxënët në një nivel më të thellë dhe më kuptimplotë. Prodhimi i medias dhe i përmbajtjes së informacionit ofron mundësinë që studentët të zhyten në mësimin për mësimin dhe bërjes. Përmes prodhimit të teksteve mediatike (për shembull audio, video dhe print), studentët janë në gjendje të eksplorojnë kreativitetin dhe të shprehin veten përmes zërave, ideve dhe perspektivave të tyre.

Shembujt përfshijnë: studentët përdorin softuer të tillë si iMovie ose Moviemaker (ose ndonjë softuer tjetër të ngjashëm pa pagesë në të cilin mund të kenë qasje) për të bërë një histori dixhitale prej një minuti për një çështje mjedisore ose ndonjë subjekt tjetër interesi.

#### — AKTIVITETET

- MIL Kërkojuni mësuesve të identifikojnë dhe përshkruajnë shembujt e secilës nga 10 qasjet pedagogjike për të mësuar për EMI të listuar më sipër, të cilat tashmë i kanë të njohura dhe që mësuesit të identifikojnë elementet kyçe që i bëjnë ato të efektshme në mësimdhënie dhe mësim të EMI-it
- Përmes punës në grup, udhëzoni mësuesit që të zhvillojnë aktiviteteteve të cilat do t'i ilustronin këto strategji në punën e tyre

## BURIMET PËR KËTË MODUL

- Edukimi Qytetar për Profesionistët e Mediave: Një Manual Trajnimi, <http://unesdoc.unesco.org/images/0018/001804/180402e.pdf>
- Të kuptojmë edukimin mbi informimin: <http://unesdoc.unesco.org/images/0015/001570/157020e.pdf>
- Big6, [www.big6.com](http://www.big6.com)
- Indikatorët e Zhvillimit të Medias: Një kornizë për vlerësimin e zhvillimit të medias, <http://unesdoc.unesco.org/images/0016/001631/163102e.pdf>
- Komiteti i Gazetarëve të Interesuar, [www.concernedjournalists.org/tools/principles/rights](http://www.concernedjournalists.org/tools/principles/rights)
- Journalism.org, <http://www.journalism.org/resources/principles>
- Edukimi mbi Median: A Kit for Teachers, Students, Parents and Professionals, <http://unesdoc.unesco.org/images/0014/001492/149278e.pdf>
- Drejt treguesve të literaturës së informimit: Dokumenti i Kornizës Konceptuale, [www.uis.unesco.org/template/pdf/cscl/InfoLit.pdf](http://www.uis.unesco.org/template/pdf/cscl/InfoLit.pdf)



## MODULI 2: TË KUPTOJMË LAJMET, MEDIAT DHE ETIKËN E INFORMACIONIT

'Qëllimi kryesor i gazetarisë është të tregojë të vërtetën në mënyrë që njerëzit të kenë informacionin të jenë sovran.'

*Jack Fuller, in News Reporting and Writing*

### HISTORIKU DHE E ARSYESHMJA

Me ardhjen e teknologjive të reja të informacionit dhe komunikimit, arritja dhe ndikimi i mediave tradicionale (radio, televizioni dhe gazeta) janë shumëfishuar, dhe informacioni dhe lajmet janë

bërë më gjerësisht të disponueshme se kurrë më parë. Në këtë kohë të informacionit, gazetarët, profesionistët e informacionit dhe mediat e lajmeve (të reja dhe të vjetra) luajnë një rol qendror në sigurimin e qasjes në informata përtej përvojave tona të menjëhershme dhe në lehtësimin e pjesëmarrjes së qytetarëve në qeverisjen e mirë dhe qeveri të hapur, demokratike dhe të qëndrueshme

Ky modul do të shqyrtojë rolin dhe funksionin e mediave të lajmeve (të reja dhe tradicionale) dhe ofruesve të tjerë të informacionit në jetën tonë personale dhe në shoqëritë demokratike, si rritja e lirisë demokratike dhe etikës së informacionit, ndërtimi i përgjegjësisë qytetare dhe shtetësisë dhe kërkimi dhe promovimi i transparencës dhe llogaridhënies . Ai gjithashtu do të japë një pasqyrë të rritjes së rolit të mediave të lajmeve, duke shërbyer vetëm si pasqyrë e shoqërisë për të qenë një rojtar i informacionit, një mbikëqyrës me një funksion kontrolli dhe balancimi, mundësues i debatit publik dhe lehtësues i pjesëmarrjes qytetare.

Moduli do t'u mundësojë mësuesve të eksplorojnë çështje të tilla si liria e informimit dhe liria e shprehjes, si dhe rëndësia e saktësisë, llogaridhënies dhe transparencës në raportimin e lajmeve.

Falë teknologjive të reja, po dëshmojmë gjithashtu një rritje të përmbajtjes së krijuar nga përdoruesit, siç janë raportet e dëshmitarëve okularë nga qytetarët. Ndërsa ky fenomen na paraqet një larmi të madhe zërash dhe perspektivash, ajo gjithashtu përforcon nevojën për të vlerësuar në mënyrë kritike shumë burime të lajmeve dhe informacioneve që gjenden sot. Duke u edukuar mbi mediat dhe informacionet, mësimeve do të jenë në gjendje jo vetëm të analizojnë dhe vlerësojnë informacionin dhe lajmet që marrin çdo ditë, por edhe të ushtrojnë përgjegjësinë e tyre qytetare për të kërkuar raportim të drejtë dhe të saktë të lajmeve, si dhe për të avokuar media të lira, të pavarura dhe pluraliste.

#### NJËSITË

1. Gazetaria dhe shoqëria
2. Liria, etika dhe përgjegjësia
3. Çfarë e bën një lajm: shqyrtimi i kritereve
4. Zhvillimi i procesit të lajmeve: tejkalimi i pyetjeve çfarë, kush, ku, kur dhe si.

## NJËSIA 1: GAZETARIA DHE SHOQËRIA

► KOHËZGJATJA: 2 orë



## TEMAT KRYESORE

- Evolucionin e konceptit dhe praktikës së 'fjalës së lirë' dhe 'shtypit të lirë'
- Qëllimi i gazetarisë në shoqëri dhe roli i saj në arkitekturën e demokracisë (p.sh. liria, përgjegjësia qytetare, transparencë dhe llogaridhënia)
- Roli dhe përgjegjësitë e gazetarëve në shekullin e 21 në arenën kombëtare dhe globale (p.sh., pasqyrë, rojtar, mbikqyrës, mundësues, lehtësues)
- Gazetaria e interesit publik, pavarësia editoriale kundrejt ndikimit të pronësisë
- Roli i etikës së informacionit

## OBJEKTIVAT E TË MËSUARIT

Pas përfundimit të kësaj njësie mësimore do të jenë në gjendje të:

- gjurmojnë zhvillimin e konceptit dhe praktikës së 'shprehjes së lirë' dhe 'shtypit të lirë'
- përcaktojnë qëllimin e gazetarisë dhe rolin e saj në forcimin ose ndjekjen e demokracisë dhe qeverisjes së mirë, dhe
- vlerësojnë rolin dhe përgjegjësitë e gazetarëve dhe profesionistëve të informimit, si në arenën kombëtare dhe globale, dhe në kontekstin e interesit publik

## QASJET PEDAGOGJIKE DHE AKTIVITETET

'Qytetërimi ka prodhuar një ide më të mirë se tjetrën -nacioni që njerëzit mund ta qeverisin vetën. Dhe ka krijuar një teori të gjerë të pa artikuluar të informacionit për ta mbajtur atë ide të quajtur gazetari. Të dyja ngriten dhe bien së bashku.'

Bill Kovach dhe Tom Rosenstiel, *Elementet e Gazetarisë*

Liria e shprehjes - nganjëherë e njohur si fjalim i lirë - është konsideruar prej kohësh si një e drejtë themelore, thelbësore për realizimin e potencialit tonë të plotë njerëzor, një themel i të drejtave dhe lirive të tjera dhe përkrahëse në zhvillimin social dhe ekonomik. Por liria e shprehjes ka nevojë për platforma publike që lejojnë që shkëmbimi i informacionit dhe ideve të jetë efektiv, pra roli i rëndësishëm i medias në sigurimin e këtyre platformave. Megjithatë, për të përmbushur këtë funksion, media duhet të jetë e pavarur nga kontrolli shtetëror ose qeveritar. Kjo liri nga rregulloret, nga ana tjetër, i detyron gazetarët që të sillen në mënyrë etike, pra zhvillimi i kodeve profesionale që merren me standardet gazetareske.

Gjatë shqyrtimit të këtyre çështjeve, lehtësuesi i trajnimit mund të zgjedhë nga:

### — AKTIVITETET

- Mësimdhënësit caktohen të hulumtojnë dhe raportojnë për evoluimin e "fjalës së lirë" dhe "shtypit të lirë" në vendin e tyre. Raporti do të përfshijë një afat kohor vizual të pikave historike, siç janë:
  - Zhvillimet historike në evolucionin e teorisë dhe praktikës së "fjalës së lirë" dhe "shtypit të lirë"
  - Gazetarë dhe / ose agjenci mediatike që dhanë kontribute të veçanta për lirinë e shtypit dhe demokracinë

- Ngjarjet në lëvizjet demokratike ku mediat dhe reportimi i lajmeve luanin një rol të rëndësishëm
  - Nëse është e mundur, lehtësuesi i trajnimit i cakton mësuesit të intervistojnë gazetarë mbi pikëpamjet e tyre mbi rolin e gazetarisë në promovimin ose ndjekjen e demokracisë. Intervistuesit do të kërkohen t'iu referohen momenteve kur reportazhet e mediave kanë luajtur një rol kyç në pamjen kombëtare ose internacionale, si dhe në menaxhimin e tenseve potenciale në mes interesave të pronësisë dhe interesit publik. Mësuesit pastaj shkruajnë një dokument reflektimi prej dy faqesh bazuar në intervistën, duke indikuar funksionin specifik të mediave, mënyra përmes të cilës operojnë mediat dhe çështjet kryesore të cilat u adresuan.

## REKOMANDIMET E VLERËSIMIT

- Dokument reflektimi mbi rezultatet e leximeve dhe/ose intervistave
- Ese ose blog mbi çështjet që kanë të bëjnë me mediat dhe demokracinë
- Pjesëmarrja në aktivitetet grupore të të mësuarit (p.sh. punëtoritë, diskutimet në klasë etj.)

## TEMA PËR SHQYRTIM TË MËTEJSHËM

- Studimet e rastit në shtyp të kontrolluar
- Propaganda vs. gazetaria

# NJËSIA 2: LIRIA, ETIKA DHE LLOGARIDHËNIA

► KOHËZGJATJA: 2 orë

## TEMAT KRYESORE

- Liria e shtypit, liria e shprehjes, liria e informacionit dhe etika e informacionit
- Kodet e etikës, kodet e praktikës dhe vlerave globale në redaksi: udhëzimet për gazetarë dhe profesionistët e informacionit
- Etika gazetareske në mbledhjen dhe procesimin e lajmeve (komitetit etik, ombudspersoni, këshilli/shtypi i pavarur, komisionet e ankesave të shtypit)
- Avokuesit e lirisë së shtypit dhe mbikqyrësit e mediave
- Të drejtat dhe përgjegjësitë e qytetarëve: lidhja në mes gazetarit dhe qytetarit
- Raportimi qytetar dhe përmbajtja e krijuar nga përdoruesit

## OBJEKTIVAT E TË MËSUARIT

Pas kompletimit të kësaj njësie, mësuesit do të jenë në gjendje të:

- përshkruajnë parimet universale të lirisë së shtypit, lirisë së shprehjes dhe lirisë së informimit dhe implikimet e tyre në raportimin e lajmeve
- analizojnë se si aplikohet etika në praktikën e gazetarisë dhe profesionistëve të informacionit në nivelin personal, profesional dhe global
- vlerësojnë rolin e avokatëve për lirinë e shtypit dhe mbikqyrësve të mediave në ndjekjen dhe mbrojtjen e lirisë dhe përgjegjësisë së shtypit
- të shpjegojnë të drejtat dhe përgjegjësitë përkatëse të qytetarëve si pjesë e lakut në praktikën e gazetarisë dhe profesionistëve të informacionit; dhe
- të kuptojnë dhe analizojnë raportimin e qytetarëve ose evolvimin e rolit të qytetarëve ose gazetarëve joprofesionistë si pjesëmarrës aktiv në krijimin e përmbajtjes së mediave dhe në procesin demokratik të debatit publik

## QASJA PEDAGOGJIKE DHE AKTIVITETET

### ‘Në fund gazetaria është një veprim i karakterit’.

Bill Kovach dhe Tom Rosenstiel, *Elementet e Gazetarisë*

Nëse shteti kërkon të rregullojë mediat, ai do të ndërhyjë në pavarësinë e gazetarëve dhe në aftësinë e tyre për të raportuar ngjarjet në mënyrën të cilën ata e konsiderojnë më të mirë. Por mediat janë aktorë socialë të cilët mund të ushtrojnë pushtet të madh në shoqëri, kështu që për të mbrojtur lirinë e tyre nga rregullimi dhe kontrolli, zakonisht besohet se gazetarët duhet të rregullojnë veten duke miratuar kodet e sjelljes etike ose duke përcaktuar udhëzime profesionale se si tregimet ose ngjarjet duhet të raportohen.

## APLIKIMI – KODI I ETIKËS GAZETARESKE

- Shqyrtoni kodin e etikës të vendosur nga gazetarët - (një shembull është kodi i etikës i themeluar nga Federata Ndërkombëtare e Gazetarëve, një shembull tjetër do të ishte standardi profesional i BBC-së). Vlerësoni qëllimin e synuar të çdo elementi të kodit
- Diskutoni pse një kod i etikës duhet të zhvillohet dhe miratohet prej vetë anëtarëve të profesionit dhe jo t’iu imponohet nga agjentët ose autoritetet e jashtme
- Diskutoni mekanizmat të cilët nevojiten për të zbatuar kodin e etikës

# APLIKACIONI – KODI I ETIKËS PROFESIONALE PËR PROFESIONISTË TË INFORMACIONIT

- Shqyrtoni kodin e etikës të krijuar nga profesionistët e informacionit, si bibliotekarët ose arkivistët, duke përfshirë parimet dhe vlerat kryesore (p.sh. grupin e kodeve etike për arkivistë të themeluar nga Këshilli Ndërkombëtar i Arkivave ose kodet profesionale të etikës të zhvilluar nga vendet individuale për bibliotekarët, siç është Shoqata e Bibliotekës Amerikane)
- Diskutoni çështjet e etikës së informacionit në lidhje me pronësinë, qasjen, privatësinë, sigurinë dhe komunitetin
- Diskutoni se si etika e informacionit ndikon në vendimet personale, praktikën profesionale dhe rregulloret publike
- Diskutoni se si zhvillimi i formateve dhe nevojave të reja të informacionit ndikon në parimet etike, dhe si zbatohen këto kode (p.sh. ruajtja digjitale, privatësia dhe qasja në informata publike)

## — AKTIVITETET

Mësimdhënësi kërkohet të kërkojë Indeksën e Lirisë së Shtypit të Freedom House ([www.freedomhouse.org](http://www.freedomhouse.org)) ose Indeksën e Lirisë së Lëvizjes në Botë të Raportuesve pa Kufij, ose një masë relevante rajonale, si Afrobarometri i medias dhe të përcaktojë vlerësimin që vendi i tij ose i saj ka marrë. Nxënësi do të: (1) shpjegojë nëse ai ose ajo pajtohet me vlerësimin dhe (2) identifikojë dhe shpjegojë faktorët ose variablat që kanë ndikuar në vlerësimin e lirisë së shtypit të vendit të tij / saj.

Kriteret e përfshira në këto sfera përfshijnë

- Shkalla e lirisë së shtypit, transmetimit dhe mediat online (p.sh. Interneti)
- Mjedisi ligjor për mediat
- Presionet politike të cilat ndikojnë në raportim
- Faktorët ekonomik të cilët ndikojnë në qasjen ndaj informacionit
- Përqendrimi i pronësisë në media
- Sulmimet direkte në gazetarët dhe median
- Ekzistenca e monopolit shtetëror në media
- Ekzistenca e censurimit dhe vetë-cenzurimit në media
- Vështirësitë e reporterëve të huaj

Ka shumë organizata në botë që bëjnë fushata për të mbrojtur gazetarët. Disa janë ndërkombëtare, si Mbështetja Ndërkombëtare e Medias në Danimarkë, Neni 19 në Londër dhe Komiteti për Mbrojtjen e Gazetarëve në Nju Jork. Shikoni nëse ka organizata për lirinë e shtypit që janë aktive në vendin tuaj dhe si kanë kontribuar këto në mbrojtjen e lirisë së shtypit dhe lirisë së shprehjes.

Mësuesi do të tregojë shembuj të raportimit që përshkruajnë paragjykime, duke përfshirë stereotipizimin, mitin, obscenitetin dhe imazhet grafike. Mësuesit do të udhëhiqen përmes një diskutimi mbi rëndësinë e standardeve dhe udhëzimeve të përgjithshme për gazetarët dhe do të paraqesë një raport mbi çështjet e paraqitura në video. Mësimdhënësi interviston një ombudsperson të medias ose përfaqësues të një organizate mbikëqyrëse të medias (ose grup të ngjashëm) të hetojë rreth kritikave të zakonshme ose ankesave për gabimet e supozuara profesionale apo etike të gazetarëve dhe / ose organizatave të lajmeve.

Mësimdhënësi shqyrton dispozitat e kodeve të etikës dhe shqyrton nëse çështjet e ngritura mbulohen në mënyrë adekuate në kodet ekzistuese profesionale. Anëtarët e klasës i thërrasin mediat lokale për të kontrolluar nëse i kanë kodet e sjelljes për

gazetarët e tyre. Ata mund të pyesin më tej se si zbatohen këto kodeve.

- Mësimdhënësi bën një inventar të *reportazhit nga raportimi i qytetarëve* për një ngjarje ose çështje të mbuluar në mënyrë të dukshme nga media kryesore. Ai ose ajo kontrollon për gabime faktike ose për paragjykime
- Nxënësve u kërkohet të mbajnë një ditar ose një regjistër, ku vëzhgimet (ditore) në temë (p.sh. shkeljet e lirisë së shtypit / shprehjes / informacionit dhe / ose shembuj të praktikës joetike të gazetarisë) regjistrohen për përmbledhje dhe sintezë në fund të rrugës.

## REKOMANDIMET E VLERËSIMIT

- Regjistri i medias
- Dokumentet e hulumtimit p.sh. vlerësimi i lirisë së shtypit, kodet e sjelljes, raportimi i qytetarëve
- Dokumentet reflektuese në intervista, shikueshmëria në TV-filma
- Pjesëmarrje në aktivitetet e të mësuarit në grup, p.sh., punëtori, diskutime në klasë

## TEMAT PËR SHQYRTIM TË MËTUTJESHËM

- E drejta e publikut për tu informuar dhe parimet e lirisë së informimit: Neni 19
- Liria e informacionit / shprehjes: lidhjet ndërkombëtare, konventat, deklaratat dhe dokumentet, dhe ligjet kombëtare (dispozitat kushtetuese, ligjet për shpifje, siguria kombëtare)
- Qasja në ligjet dhe procedurat e informacionit, si dhe deklaratat dhe dokumentet, rekomandimet
- Përbërësit të cilët e përbëjnë një liri të mirë të ligjit dhe praktikës së informacionit
- Vetë-rregullimi dhe ombudspersoni i mediave
- Të drejtat e reporterëve

# NJËSIA 3: ÇKA E BËN LAJMIN – SHQYRTIMI I KRITEREVE

► KOHËZGJATJA: 3 ORË

## TEMAT KRYESORE

- Kriteri për vlerësimin e vlerës dhe denjësisë së lajmeve
- Konsiderata në bërjen e gjykimeve të lajmeve ose në formësimin e lajmeve

## OBJEKTIVAT E TË MËSUARIT

Pas përfundimit të kësaj njësie, mësuesit do të jenë në gjendje të:

- përshkruajnë kriterin i cili përdoret për vlerësimin e vlerës së lajmeve dhe denjësisë së ngjarjeve, personave dhe ideve, dhe
- të diskutojnë në mënyrë kritike parimet bazë në bërjen e gjykimeve të lajmeve ose në formësimin e lajmeve.

## QASJA PEDAGOGJIKE DHE AKTIVITETET

**‘Teoria e gazetarisë të cilën e kemi trashëguar e formon bazën e gazetarisë të shekullit të ri, një gazetari ku formohet kuptimi bazuar në sintezë, verifikim dhe pavarësi të fortë.’**

Bill Kovach dhe Tom Rosenstiel, *Elementet e Gazetarisë*

Gazetarët duhet të kuptojnë një sasi të madhe informacioni dhe të mendojnë se si të organizojnë në një mënyrë që nxjerr në pah çështjet të cilat janë të rëndësishme kështu që është e kuptueshme për një audience e cila do të ketë nivele të ndryshme të kuptimit të eventeve në fjalë. Gjykimet e përfshira do të përfshijnë zgjedhjen e atyre historive të cilat konsiderohen të jenë të rëndësishme (për lajme) dhe të vendosin se si ta prezantojnë informacionin. Në mënyrë të pashmangshme forma e prezantimit (nganjëherë e njohur si ‘inkuadrim’) do të reflektojnë mbi eksperiencën dhe pikëpamjen e vetë gazetarëve. Është e rëndësishme për një audience t’i kuptojë këto inkuadrime dhe të mendoj në mënyrë kritike rreth tyre.

## ANALIZA TEKSTUALE

- Mësuesi/ja analizon faktin që përbën lajmin në secilën faqe frontale të një gazete madhore (ose botimin online), duke u bazuar në kriteret për vlerësim të stories së lajmit. Kjo përfshinë këta faktor:
  - Afatet kohore
  - Ndikimi dhe rëndësia
  - Ndikimi (Rëndësia)
  - Përafërimit
  - Konflikti
  - Interesat njerezore/ të pazakonshme
  - Valuta monetare
  - Nevoja
  - Ai ose ajo pastaj analizon storiet bazuar në faktorët që duhet marrë parasysh për të bërë vlerësimin e lajmit ose për të përmirësuar lajmin. Këto janë:
    - Besueshmëria: vërtetësia (grumbullimi i fakteve) dhe koherenca (lidhja logjike e fakteve)
    - Dedikimi ndaj interesit të publikut
    - Ta informoj, në vend se ta manipuloj publikun
    - Përfundimi/kuptueshmëria
    - Diversiteti/shumëllojshmëria (përfshierja e lajmeve prej të gjitha komuniteteve, jo vetëm të një audience të caktuar)

## ANALIZA KONTEKSTUALE

Mësuesi/ja rishikon reportazhin e CNN dhe Al Jazeera (ose tjetër mediumi të zgjedhur/të ngjashëm) për një temë të caktuar dhe të një dite të vecuar, pastaj i krahason nëse ka të përbashkëta ose dallime këndvështrimi (p.sh. shitja e një këndvështrimi apo perspektive të caktuar) dhe trajtimi (p.sh. informacioni i ofruar, njohja e burimit, intervistat e bera, çfarë lloj mbështetjeje vizuale të lajmeve mediatike) i dy reportazheve

## ANALIZAT E LAJMIT DHE VETËVLERËSIMI

Studentëve u ipen dy artikuj të ndryshme të lajmit që shkruajnë për të njejtën temë dhe u kërkohet që të shpjegojnë se cila pjesë është më e fuqishme ose që ofron më shumë informacione dhe si mund të përmirsohet artikulli tjetër. (Kriteret që duhet përdorur, mund t'i gjeni te Analiza tekstuale)

## REKOMANDIMET PËR VLERËSIM

- Leter reflektimi bazuar në analizën e lajmit/analizën tekstuale/ analizën kontekstuale
- Pjesëmarrja në aktivitetet grupore të të nxënit. p.sh. punëtori, diskutime në klasë

## TEMAT PËR DISKUTIM TË MËTEJSHËM

- Cilësia e lajmit(kulturo-shoqërore, politike dhe ndikimi i ekonomisë në lajm)
- Efektet e cilësisë së lajmit në vlerat dhe proceset redaktuese të lajmit
- Vazhdimësia e informacioneve globale dhe formësimi i lajmit
- Organizatat e mediave globale të lajmit(CNN, AL Jazeera, BBC, Fox News)

## NJËSIA 4: ZHVILLIMI I LAJMIT PROCESI: TE



# SHKOSH PERTEJ 5 PYETJEVE

► Kohëzgjatja: 3 orë

## TEMAT KRYESORE

- Identifikimi i lajmit dhe njohja e historisë (zhvillimi i procesit të lajmit)
- Diciplina e verifikimit si thelb kryesor në gazetari

## OBJEKTIVAT E TË MËSUARIT

Pas përfundimit të kësaj njësie, mësuesit do të jenë në gjendje të:

- përshkruajnë procesin se si historia e lajmit është zhvilluar qysh prej idesë, mbledhjes të të dhënave deri te shkrimi i lajmit
- kuptojnë parimet baze të disiplinës së verifikimit, si të ndara nga gazetaria e mbrojtjes, dhe si aplikohen tek procesi i zhvillimit të lajmit
- analizojnë sesi reporterët e lajmit duhet aplikuar teknikat e verifikimit për të përmbushur standartinë e besueshmërisë dhe saktësisë së gazetarisë
  - kuptojnë dhe përshkruajnë raportin mes gazetarëve, burimeve të lajmit, redaktorëve të lartë dhe pronarëve të mediumit.

## QASJA PEDAGOGJIKE DHE AKTIVITETET

‘Lajmi i ditës sapo të arrijë në zyrën e gazetës është një përzierje e faktit, propagandes, thashethemeve, dyshimit, të dhënave, shpresës, frikës dhe të zgjedhesh e ta vësh në rend atë lajm, është me të vërtetë e shenjët dhe zyre priftërore në demokraci.’

Walter Lippmann, nga raportimi dhe shkrimi i lajmit

## VIZITË STUDIMORE NË MEDIUME

Vizita mund të bëhet në zyrat e medimeve të bashkëbisedojnë me redaktorin ekzekutiv ose me redaktorin e lartë dhe të shohin drejtëpërdrejtë zhvillimin e procesit të redaktimit në zyrë. Pjesëmarrësve u kërkohet të shkruajnë një letër reflektimi për atë që ata vëzhguan dhe mësuan gjatë vizitës.

## PROCESI I HULUMTIMIT (NJË DITË NGA JETA E NJË REPORTERI)

Praktikanti/ja e shoqëron reporterin/en gjatë kohës kur ai ose ajo bën punën e tij/saj në atë

fushë të caktuar dhe dokumenton : (a) çfarë elemente të lajmit janë identifikuar dhe janë shkruar për të, krahasuar me atë çfarë ka ndodhur në vendngjarje(ose procesin e analizimit të të dhënave të mbledhura); dhe (b) si dhe pse reporteri tregon ndodhinë (tu jap kuptim të dhënave)në atë mënyrë.

## ANALIZA TEKSTUALE

- Mësuesi/ja analizon shkaqet e një çështje madhore ose ndodhie dhe shqyrton informacionet. Ai ose ajo shpjegon vlerësimin, duke pasë parasysh faktorët dhe procesin në "identifikimin e lajmit dhe njohjen e historisë":

- Elementet e një lajmi(Pyetjet: Kush? Çfarë? Kur? Ku? Pse? Dhe Si?) dhe ripërcaktimin e tyre: lajmet janë të dhëna me kuptim (cili është karakteri, çfarë është komploti, ku vendoset, pse është motivimi apo shkakimi, si është narrativiteti)

- Gazetaria e "të treguaritë me një qëllim": gjetja e informacioneve që njerëzit kanë nevojë në jetën e tyre, për t'i dhënë asaj kuptim, për ta bërë tërheqëse dhe të përshtatshme Mësuesi/ja do të kontrollojë për verifikueshmeri, bazuar në parimet kryesore të verifikimit: mos shtoj; mos mashtro audiencën ;ji sa më transparent që është e mundur në lidhje me metodat dhe motivet; mbështetu në raportimin tënd origjinal; dhe ushtroni modestinë Mësuesi/ja gjithashtu do të aplikojë një teknikë të fundit për verifikim: redaktimin skeptik, listën e saktësive, metodën e verifikimit të fakteve të supozuara, rregullat e burimeve anonime etj.(Referenc: Kovach dhe Rosentiel, Elementet e Gazetarisë)

## PRODUKTI

Trajnuesi/ja ose mësuesi/ja në bashkëpunim me këshilltarin e shkollës publike(stacionit transmetues) të lejojë praktikantët të sjellin një plan për publikimin e radhës ose për program. Plani përfshinë renditjen e artikujve ose ndodhive që do shkruhen ose publikohen, qëllimi i secilës ndodhi, përfshierja dhe shikimi i secilit kënd të asaj ndodhie.

## REGJISTRA MEDIALE

Mësuesve u kërkohet të mbajnë një ditar ku(cdo ditë) vëzhgimet në një temë(p.sh.vlerat e lajmit, vlerësimi i lajmit, kriteret e verifikimit, raportimi i qytetarëve) të ruhen për përmbledhje dhe gërshetim të informacionit në fund të lëndës.

## REKOMANDIME VLERËSIMI

- Regjistra mediale
- Produkti
- Raportimi në vizite studiuëse, hulumtim, analizë tekstuale
- Pjesëmarrja në aktivitetet grupore të të nxënës. p.sh. punëtori, diskutime në klasë

## TEMA PËR DISKUTIM TË MËTEJSHËM

- Burime dhe teknika grumbullimi të lajmit(përfshirë përdorja e TIK)
- Shija dhe pështatja e reportazheve të lajmeve

## BURIMET PËR KËTË MODUL

- Joseph, Ammu. (2005): Rëndësia e Medias Qytetarëve u bën. Marrë në Maj 2011 nga 17 May 2011 from [http://portal.unesco.org/ci/en/files/19137/11164945435advocacy\\_brochure.pdf/advocacy\\_brochure.pdf](http://portal.unesco.org/ci/en/files/19137/11164945435advocacy_brochure.pdf/advocacy_brochure.pdf)
- Article 19. (1999, Qershor). E drejta për të ditur: Parimet e lirisë dhe legjislacionit të informacionit. Seria e Standardeve Ndërkombëtare. Marrë më 27 Maj 2009 nga [www.article19.org/pdfs/standards/righttoknow.pdf](http://www.article19.org/pdfs/standards/righttoknow.pdf)
- ASLIB Training Suite. Liria e Informacionit.. (2004). Retrieved 15 February 2004 from <http://www.aslib.com/training>
- Bertrand, Claude-Jean. (2003). Sistemet e etikës së medias dhe llogaridhënies.
- Coblenz, W. (Producer) and Goldman, W. (Writer). (1976). Të gjithë burrat e Presidentit (Film). Warner Bros
- Komiteti për Mbrojtjen e Gazetarëve, at <http://www.cpj.org>
- Dominick, J. R. (2007). *Dinamika e komunikimit masiv*. 9th ed. Boston: McGraw-Hill
- Humanext. Trajnimet e Etikës. (2009). Ankerstar dhe Balancimi i Etikës Personale dhe Profesionale(programi me Trainer's Guide, ushtrime riprodhuese, fletëpalosjet, studimet e rasteve); Seminari i Dr Louis V. Larimer mbi Arsytimin Etik (me Tipin Etik Tregues dhe Trajnimi Manual). Marrë më 22 prill 2009 nga <http://www.newtrainingideas.com/ethics-training.html>
- Kovach, B. and Rosenstiel, T. (2001). Elementet e gazetarisë: Çfarë Profesionistët e Lajmeve duhet të dinë dhe çfarë publiku duhet të presë. New York: Three Rivers Press of Random House;
- Mencher, Melvin. (2006). Raportimi dhe shkrimi i lajmeve (edicioni i dhjetë )Boston: McGraw-Hill
- Mendel, Toby. (2008). *Liria e Informacionit: Një Studim Ligjor Krahasues* (2nd Ed.). Paris: UNESCO, at <http://unesdoc.unesco.org/images/0015/001584/158450e.pdf>
- Poynter Institute, at <http://www.poynter.org>
- Reporters sans frontiers, at <http://www.rsf.org>
- Rosenstiel, Tom and A. Mitchell (eds). (2003). *Duke menduar qartë: Rastet e Vendimarrjes gazetaresk*. New York: Columbia University Press
- Gjendja e Lajmeve mediale, at <http://www.journalism.org>
- Ward, S.J.A. (2005). Parimet Filozofike të Etikës së Gazetarisë Globale. *Gazeta e Etikës së masmediave* 20:1, 3-21
- Woodward, Bob and Carl Bernstein. (1974). *Të gjithë burrat e Presidentit*. New York: Simon and Schuster;
- UNESCO. (2009) Udhëzimet për Transmetuesit që Promovimojne Përdoruesit e Permbajtjeve të Pergjithshme dhe Edukimi mbi Median dhe Informacionin. Paris: UNESCO, at <http://unesdoc.unesco.org/images/0018/001871/187160e.pdf>
- UNESCO. (2007). *Kurrikula Model për Edukimin e Gazetarisë për Vendet dhe Demokracitë në Zhvillim*. Paris: UNESCO, at <http://unesdoc.unesco.org/>

images/0015/001512/151209e.pdf

▪ Universiteti i Kansasit. Historia e Gazetarisë Amerikane. (2009). Retrieved 22 April 2009

from <http://ehub.journalism.ku.edu/history/1920/1920.html>



# MODULI 4: GJUHËT DHE INFORMACIONI NË MEDIA

'Gjuha është burim i keqkuptimeve.'

101

Antoine de Saint-Exupéry (1900 - 44)

## HISTORIKU DHE SHPJEGIMI

'Mediumi është mesazh', kjo thënie e famshme, është shkruar nga Marshall McLuhan në vitin 1964. Përderisa mediumi mund të kete ndikim sesi mesazhi kuptohet, përvoja/sfondi personal gjithashtu mund të kete ndikim në interpretimin e atij mesazhi. Hap parësor dhe i rëndësishëm është që media dhe informacionet të kuptojnë sesi informatat, idetë dhe kuptimi percillen përmes formave të ndryshme mediatike sic janë libraritë, arkivat, muzet dhe interneti. Secili medium ka 'gjuhën' e saj ose 'gramatikën' që përdoret për të përcuar mesazh në një mënyrë të vecantë. 'Gjuha' në këtë sens nënkupton që përbërësit teknik dhe simbolikë ose kodet dhe mënyrat të cilat media i përzgjedh, janë një hap drejt komunikimit të ideve, informatave dhe dijes. Kodet teknike përfshijnë zërimin, këndet e kamerës, llojet e xhirimit dhe ndricimi. Për shembull mund të përdorin muzike ogurzi për të treguar tipare rreziku në film, ose të xhiroj në një kënd të lartë në mënyrë që të krijoj ndjesi të fuqishme në fotografi. Kodet simbolike përfshijne gjuhën, veshjen ose veprimet e karaktereve, ose simboleve portretizuese lehte të kuptueshme. Për shembull, një trëndafil i kuq mund të përdoret në mënyrë simbolike për të treguar dashuri, ose dora e mbledhur si grusht për të shprehur zemërim. Mediat në gjuhën që përdorin mund të përfshijne një numer të caktuar fjalësh, fraza, imazhe që përsëriten, e që njihen si gjuhë verbale ose pamore. Kur studiojmë gjuhën e mediave, tri pyetje kryesore duhet të mirren parasysh: Si kuptohet/përceptohet gjuha e mediave nga audienca? Cilat janë disa nga kodet dhe mënyrat që përdoren nga personat që punojnë në media në ditët e sotme? Një tjetër pyetje e rëndësishme është nëse persona të ndryshëm, nxjerrin kuptime të ndryshme nga një tekst apo artikull me informacion të njejtë.

Ky modul ka për qëllim trajnimin e mësuesve në mënyrë që ata të mësojnë llojshmërinë e gjuhëve që mediat përdorin, të kuptojnë format se si një mesazh mund të përcohet dhe si interpretimi i informatave apo ideve të marra nga mediat e ndryshme të informimit lidhet ngushtë me llojin e gjuhës që përdoret.

### NJESITE

1- Leximi i teksteve informative dhe mediat

2- Mediumi dhe mesazhi: printo dhe transmeto lajmin

3- Zhanri film dhe tregim

## NJËSIA 1: LEXIMI I TEKSTEVE

# INFOMACTIVE DHE MEDIAT

► KOHËZGJATJA: 2 orë

## TEMAT KRYESORE

- Shqyrtimi i kodeve dhe mënyrave në tekstet informative
- Analizimi i kuptimit:- simbolet dhe gjuha pamore
- Eksplorimi i gjuhës në media- fotot dhe kolazhet në video

## OBJEKTIVAT E TË MËSUARIT

Pas përfundimit të kësaj njësie, mësuesit do jenë në gjendje të:

- Të identifikojnë kodet dhe mënyrat që përdoren të percojnë mesazh ne mediume të ndryshme dhe tekste informative.
- Të identifikojnë shenjat dhe simbolet që përdoren për qëllime të ndryshme në komunitete lokale dhe ato globale

## QASJET PEDAGOGJIKE DHE AKTIVITETET

- Permend disa nga teknikat dhe kodet simbolike, mënyrat që përdoren në media dhe tekstet informative: serialet, broshurat turistike, filmat dokumentar, komedit familjare dhe reklammat politike. Cfarë mesazhe dhe informacione percohen përmes këtyre kodeve?
- Identifikoni shenjat dhe simbolet që përdoren për qëllime të ndryshme në komunitet në mënyrë që të bartet informacioni(p.sh. për udhëzime, lokacione të atraksioneve, etj.) Përshkruani 'gjuhën' verbale dhe vizuale të përdorura në këto shenja dhe simbole që në përgjithësi kuptohen nga njerëzit e komunitetit tuaj. Duhet pasë parasyshë përdorimin e fontit, imazhe të formesuara, dizajni etj.
- Ekzaminoni kartolina të ndryshme nga vendi apo komuniteti juaj. Identifikoni kodet kryesore teknike dhe simbolike në secilen prej tyre. Cfarë informacioni percillet për vendin tuaj përmes këtyre kodeve? Cfarë informacioni fshihet? Krijoni një kartolinë për një vend apo organizatë që ti përzgjedh. Cfare kode teknike dhe simbolike do përdorje për të përcjell informacione të rëndësishme dhe të krijosh përshtypjen e dëshiruar.
- Përdorni imazhe(fotografi) ose video, krijoni kolazhe të imazheve për ta treguar rëndësinë e shkollës tuaj tek audiencia e përzgjedhur. Ta keni në konsiderat përdorimin e ikonave, simboleve, gjuhës verbale/vizuale, muzikës, ngjyrave, xhirimi dhe këndet e duhura etj., për t'ju drejtuar dhe përfshirë këtë audienc. Audiencia për këtë kolazh mund të jenë studentët e mundshëm të cilët ndjekin mësimet në shkollë, prindërit e këtyre studentëve, kujdestarët e shkollës, politikanë e kështu me radhë

## REKOMANDIMET PËR VLERËSIM

- Analizimi i kodeve dhe mënyrave të përdorura në tekste të ndryshme
- Analizimi i shenjave dhe simboleve në komunitet

- Analizimi dhe vlerësimi i kodeve të përdorura në kartolinat lokale ose ato nacionale
- Krijimi i kolazheve

## **NJËSIA 2: MEDIUMI DHE MESAZHI: PRINTIMI DHE TRANSMETIMI I LAJMIT**

► Kohëzgjatja: 2 orë

## TEMAT KRYESORE

- Analizimi i kodeve dhe mënyrave në media
- Aplikimi i kodeve dhe mënyrave tek një storie e re
- Gjuha dhe kuptimi në media: vlerësimi dhe analizimi i informacioneve dhe lajmeve

## OBJEKTIVAT E TË MËSUARIT

Pas përfundimit të kësaj njësie, mësuesit do të jenë në gjendje të:

- Analizojnë kodet dhe mënyrat që përdoren në televizion, radio dhe reportazhet e gazetave
- Aplikojnë këto kode dhe mënyra tek një lajm i caktuar
- Vlerësojnë sesi një medium bashkë me kodet dhe mënyrat e caktuara, mund ta formësoj mesazhin që përçon.
- Vlerësojnë informacionin që duan të përcjellin përmes një mediumi të caktuar

## QASJET PEDAGOGJIKE DHE AKTIVITETET

- Qeveria po planifikon ndryshimin e legjisllacionit dhe kjo do të ndikoj negativisht në mbrojtjen e mjedisit. Një zyrtar i qeverisë sapo ka mbajtur një fjalim për të arsyetuar qëndrimin e qeverisë. Një grup i të rinjeve po protestojnë dhe shperthen një përplasje mes protestuesve dhe policisë.
- Mendojeni sesi kjo ngjarje mund të shkruhet nga një gazetë, të shfaqet në televizion apo radio. Si mendoni që reportazhi do të ndryshoj dhe pse? Bazuar në karakteristikat unikë të secilit medium, cfarë ndryshimesh mund të kete?
  - Përzgjedh një ngjarje aktuale ose çështje interesi, rregullat e reja të shkollës, ndonjë ngjarje të fundit kulturore, politike, ose shëndetsore. Punoni në grupe, bëni një lajm në këtë event që do të shfaqet në radio, gazetë dhe në programin lajmeve në televizion. Për radio historia nuk duhet të jetë më e gjatë se 20 sekonda; për gazetë, 210 fjale; dhe për televizion, 1-2 minuta. Pas përfundimit të storieve, diskutoni rezultatet duke përdorur pyetjet si udhëzim ashtu si vijojnë:
  - Si mediat e ndryshme ndikojnë në llojin e repostazhit dhe informacionit që japin?
  - Cfarë kode dhe mënyra janë përdorur për zhvillimin e seciles storie?



- Si është ky ushtrim një shembull i frazës 'mediumi është mesazhi' ?
- Krijoni një kolazh të imazheve ose simboleve që mund të përdoren për të promovuar një shkollë apo institucion tjetër, duke e pasë parasyshë audiencën e shënuar dhe informacionin që doni të përcillni.

## REKOMANDIMET PËR VLERËSIM

Përshkrimi dhe vlerësimi i llojeve të reportazheve të lajmit që janë të mundura të shfaqen në medime të ndryshme

- Analizimi dhe zhvillimi i storieve të lajmit në radio, televizion dhe gazeta

## NJËSIA 3: ZHANRI I FILMIT DHE TREGIMI

► KOHËZGJATJA: 2 orë

## TEMAT KRYESORE

- Zhanri i filmit
- Kodet teknike dhe simbolike në film
- Skenimi ilustrues i skenës së filmit

## OBJEKTIVAT E TË MËSUARIT

Pas përfundimit të kësaj njësie, mësuesit do të jenë në gjendje të:

- Identifikojnë një sërë zhanresh të filmit, kodet dhe mënyrat të ndërlidhura mes vete (përdorimin e teknikave të filmit, tematiken, karakteret, vendosjen, situatat dhe ngjarjen)
- Identifikojnë kode të vecanta teknike dhe simbolike që përdoren për të përcjell mesazhin e filmit
- Zhvillojnë sekuenca ilustruese për skenat e filmit që përfshijne kodet dhe mënyrat e një zhanri të caktuar
- Identifikojnë kodet dhe mënyrat që përdoren në një zhaner të filmit e që janë të njohura në vendet tjera.

## QASJET PEDAGOGJIKE DHE AKTIVITETET

- Bëjnë një list zhanresh të filmit që e pëlqeni. Identifikoni elementet kryesore që përbëjnë secilin zhaner. Shiko një skenë nga njëri nga këta filma. Kushtoj vëmendje: zhvillimit të ngjarjes, vendit, llojeve të karaktereve, muzikës, ndricimin, efektet speciale që janë në film? Shpjegoni se si kuptimi i asaj skene ndryshon varësisht prej elementeve (p.sh ndryshimi i vendit, fonogramit etj.)
- Në grupe, krijoni skica ilustruese nga një skene të një filmi me zhanërin që ju zgjidhni. Shpjegoni sesi 'gjuha' e atij zhanri pasqyrohet në secilën skenë
- Duhet tu shfaqni mësuesve një sekuencë nga një film i famshëm të një vendi të huaj. Krahasoni të përbashkëtat dhe dallimet e 'gjuhës' së filmit që janë përdorur në vendin e tyre. Diskutoni ndikimin e teknikave që janë përdorur. Cfarë kumtohet përmes këtyre teknikave? Cfarë mendoni, cila është audiencia për secilin film?
- Për të gjetur dy postera të të njëjtit film të shfaqur në vende të ndryshme, përdorni internetin ose librarinë lokale për t'i gjetur dhe përgjigjuni këtyre pyetjeve:
  - Cfarë përshtypje krijohet për filmin përmes posterave?
  - Cfarë teknika ose simbole janë përdorur? Në çfarë shkalle?
  - A mundeni të dalloni ciles audiencë i referohet filmi, bazuar në postera?
  - Cfarë informacioni përcillet për filmin përmes posterave?

## REKOMANDIMET PËR VLERËSIM

- Analizimi i një skene të filmit

- Krijimi i një skice ilustruese për një skenë të filmit
- Analizimi i posterit të filmit
- Krahasimi i filmit

## TEMA PER DISKUTIM TË MËTEJSHËM

- Përdorimi i fonogrameve(muzikes)
- Puna e artistëve Foley që krijojnë efekte të zërit
- Mënyrat e krijimit të filmave dokumentar

## BURIMET PËR KËTË MODUL

Burimet e cituara më poshtë janë vetëm ilustruese dhe kryesisht janë marrë nga Amerika e Veriut dhe Mbretëria e Bashkuar. Mund të mos gjejnë përshtatshëm jashtë këtij rajoni kështu që trajnerët duhet të zhvillojnë ose të hulumtojnë burimet e tyre bazuar kryesisht në rajonin e tyre.

- Goodman, Steve. (2003). Mësimdhënia e Mediasë të të Rinjve: Një Udhëzues Kritik për Edukimin, Video Prodhimi dhe Ndryshimi Social NY: Teacher's College Press.
- Hitchcock, Peter. (1992). Videography: Udhëzues për të bërë Videot. Ontario, Canada: Peter Hitchcock Productions.
- Jenkins, Henry. (2006). Convergence Culture: Ku Media e Vjetër dhe Media e Re Ndashën. US: New York University.
- McLuhan, Eric and Zingrone, Frank. (1995). Esenciale McLuhan. Canada: Anansi.
- Bone, Jan and Johnson, Ron. (2001). Të Kuptuarit e Filmit: Hyrje në Vlerësim Të Filmit. US: Glencoe McGraw Hill.
- Bordwell, David and Thompson, Kristin. (1998). Film Art: Një hyrje. Edicioni i 6-të. US: McGraw Hill.
- Edukimi i Filmit, 91 Berwick Street, London UK W1F 0BP . Kjo përfshinë një shumëllojshmëri të materialeve për mësimdhënie dhe udhëzuesve të jashtëzakonshëm, shumë prej të cilave mund të shkarkohen nga kjo faqe e internetit, [www.filmeducation.org](http://www.filmeducation.org).
- Udhëzues për Studime të Filmit për Shkollën e Mesme. Shkarkuar nga Cinematheque Pacific dhe shpërndarë nga Agjensia e Mësimit të Hapur të BC, Kanada, këto përfshijnë udhëzime studimore për filma individual [www.cinematheque.bc.ca](http://www.cinematheque.bc.ca)
- Bordi Kombëtar i Filmit të Kanadasë. [www.nfb.ca](http://www.nfb.ca) NFB punon me shkollat publike, bibliotekat dhe muzetë për të bashkuar Edukimin dhe filmat dokumentarë.
- Howard, Sue ed. (1998). Wired-Up: Të rinjtë dhe mediat elektronike. UK:Routledge. Kjo antologji është hartuar si një hyrje e arritshme për hulumtime të rëndësishme në lidhje me teknologjitë e reja të komunikimit.



# MODULI 6: MEDIAT E REJA DHE TRADICIONALE

## HISTORIKU DHE SHPJEGIMI

Kjo njësi ka për qëllim t'i njoftoj mësuesit me rolin e gërshetimeve të risive teknologjike që kanë në zgjerimin e përfshirjes së qytetarëve në ndryshimet shoqërore, ekonomike dhe politike. Shpjegon sesi teknologjia e re dhe format e mediave elektronike (lajmet online, bllogjet, Ëikipedia, YouTube, aplikacionet sociale, video lojrat etj) kanë evoluar nga ajo tradicionale dhe po mundësojnë qasje më të madhe ndaj informacioneve, lirisë së shprehjes, qeverisjes së mirë dhe pjesëmarrjen në proceset demokratike.

Bashkëekzistenca e mediave të shkruara, mediave transmetuese (radio dhe televizioni), interneti, telefonat mobil etj., po mundëson qarkullimin e përmbajtjeve mediatike nëpër platforma të ndryshme, duke zgjeru kështu qasjen ndaj informacioneve dhe krijimin e një kulture përfshirëse ku qytetarët në mënyrë aktive marrin pjesë në rezultatet dhe shpërndarjen e informacioneve. Teknologjia e informacionit dhe komunikimit (TIK) ka hapur mundësitë për pjesëmarrje më të madhe të audiencës në shpërndarjen e informacioneve duke i inkurajuar kështu që njerëzit të përfshihen në proceset demokratike dhe shoqëria të jetë më e hapur.

Si efekt, teknologjia e re dhe gërshetimi i saj në media po krijon hapësirë për vetëshprehje dhe pjesëmarrje në diskutime publike në një rang kogja të gjere në çështjet politike, ekonomike dhe shoqërore. Platformat e reja mediale po u mundësojnë qytetarëve që vazhdimisht të bashkëvëprojnë në proceset shoqërore si dhe po sjellin sa më afër lajmet globale tek shoqëria lokale.

### NJESITE

1. Nga mediat tradicionale tek teknologjitë e reja të medias
2. Përdorimi i teknologjive të reja të medias në shoqëri - komunikim masiv dhe digjital
3. Përdorimi i mjeteve interaktive multimediale, duke përfshirë lojra digjitale në klasa

# NJËSIA 1: NGA MEDIAT TRADICIONALE NE TEKNOLOGJITE E REJA TE MEDIAVE

► Kohëzgjatja: 2 orë

## TEMAT KRYESORE

- Ndryshimi dhe vazhdimësia- një histori e shkurtër në lidhje me mediat
- Cfarë është konvergjenca(gërshetimi) e mediasë
- Media dixhitale si media e re
- Dallimet kryesore në mes mediasë tradicionale dhe asaj bashkëkohore

## OBJEKTIVAT E TE MESUARIT

Pas përfundimit të kësaj njësie, mësuesit duhet të jenë në gjendje të:

- Shpjegojnë shkurtimisht historinë e mediasë
- Përshkruajnë sesi teknologjia e re ka gërshetu mediat tradicionale dhe ate bashkëkohore
- Gjejnë dallimet mes medias tradicionale dhe asaj bashkëkohore dhe si kjo e fundit ka mundësu pjesëmarrjen në demokraci

## QASJET PEDAGOGJIKE DHE AKTIVITETET

- Një zhvillim i rëndësishëm së bashku me zhvillimin e mediasë dixhitale ka qenë kalimi prej modelit të transmetimit tradicional të printimit dhe transmetimit prej'një tek shumë', tek modeli 'peer to peer'(ang.)që lehtëson bashkëpunimin dhe shpërndarjen e lajmit. Përmes dixhitalizimit, lajmi është lëhtë i qasëshem nga paisje të ndryshe duke filluar nga radio, televizioni, kompjuteri personal dhe ndoshta cfarë është më e rëndësishmja dhe dominuese telefonat mobil që mund të shpërndajnë të gjitha llojet e lajmit. Dixhitalizimi i zërit, imazheve, tingullit dhe konvergjenca e të dhënave- ku po krijohen mundësi të reja interaksioni.
- Praktikantëve në grupe u janë dhënë detyra për hulumtimin e evolucionit të mediasë deri tek nevoja emergjente e internetit, dhe të vështrojnë sesi interneti në fillim është përdorur dhe si ka arrit të përdoret kaq shume tash në shoqeri. Duhet të vlerësojnë aplikimin dhe të mirat që ka në edukim, shoqërinë civile dhe qeverisjen. Rezultatet e kësaj pune duhet prezentuar në formë diskutimi në klasë.
- Praktikanët hulumtojnë deri në cfarë shkalle mediat dixhitale jane duke hap mundësi dhe liri te shprehjesë në shoqëri. Në hulumtimin e tyre, ata duhet kushtuar vëmendje përdorimit të mediave nga njerëzit per vetëshprehje. Ata poashtu duhet të vrenjë sesi mediat tradicionale(gazeta, radio dhe televizioni) konvergjohe me bashkëkohore(p.sh.faqet online të lajmit me mundësi aksesit). Praktikantët duhet prezantuar gjetjet e tyre duke perdorur PowerPoint ose forma tjera të prezantimit.

- Praktikantët po hulumtojnë në qfarë shkalle media bashkëkohore po sfidon medianë tradicionale dhe atë shoqërore. Dallimi mes llojeve të ndryshme të mediasë ku njerëzit po e përdorin për të shprehur këndëveshtrimet në artikuj të ndryshme lajmi dhe së bashke me çështjet dhe temat e caktuara. Rezultatet e kësaj pune duhet prezentuar në formë diskutimi në klasë.

## — AKTIVITETET

- Shkruani një ese të shkurtër për dallimet kryesore në mes mediasë tradicionale dhe asaj bashkëkohore, diskutoni deri në çfarë mase dallimet janë të vërteta ose të rreme. Në ese, vlerëso të ngjajshmet dhe dallimet në mes mediasë tradicionale dhe asaj elektronike. Problemet e përgjegjësive editoriale, verifikimi dhe parimet e tjera gazetareske duhet nënvizuar.
- Një karakteristikë e mediasë tradicionale është që lajmi shkon përmes një procesi editorial për të origjinalizuar storiet e reja dhe ta atribuojë të një medium të caktuar e jo tek ata individual. Qytetari nuk ka qasje online në këtë proces, Në këtë kontekst, diskutoni dallimin në mes një opinioni që është lajm në një bllog i shprehur nga një individ dhe raportimi i lajmit në verzionin e gazetës online.
- Hulumtoni dhe shkruani një raport sesi i informacioni ka ndryshuar apo ka mbetur i njëjtë në mediat bashkëkohore me zhvillimin e teknologjisë
- Përgatiteni një ese sesi nevoja për medianë bashkëkohore ka ndikuar në interaksionin e njerëzve dhe cka përfitojnë ata. Gjithashtu pyesni sesi media e re po ndikon shoqërinë dhe jetën akademike të mësuesve, si dhe cilat janë mundësitë për të përmirësuar qasjen ndaj mediasë digjitale.

# BASHKËKOHORE NË MASS KOMUNIKIM DHE DIXHITALIZIM

► Kohëzgjatja: 2 orë

## TEMAT KRYESORE

- Media bashkëkohore dhe interaksionet-rrjetet sociale etj
- Teknologjia e zhvillimit dhe komunikimit
- Ndërlidhja mes ndryshimeve në komunikim masiv si rezultat i teknologjisë së re dhe ndryshimet në institucionet demokratike.

## OBJEKTIVAT E TË MËSUARIT

Pas përfundimit të kësaj njësie, mësuesit duhet të jenë në gjendje të:

- Analizojnë ndikimin e komunikimit elektronik në jetën sociale dhe politike të një shoqërie.
- Përshkruajnë një formë ose dy të medimeve të reja për të shpërndar informacione në lidhje me aktualitetet në shoqëri.
- Vlerësojnë sesi mediat ndikojnë në institucionet demokratike, proceseve shoqërore dhe në komunikim masiv.

## QASJA PEDAGOGJIKE DHE AKTIVITETET

Hulumtimi dhe diskutimi në klasë: Praktikantët marrin përsipër një hulumtim të një shkalle jo fort të gjerë për të matur ndikimin e zhvillimit të teknologjisë elektronike të komunikimit: këtu përfshihet të nxënit rreth platformave mediale që përdoren në vendin e tyre dhe sesi media prezanton vendin e tyre ndaj botës. Praktikantët duhet shiku ëbësite-t e vendit të tyre dhe të diskutojnë në grupë sesi duhet projektuar dhe të bëjnë krahasime me vendet fqinjë. Duhet përzgjedh se çfarë karakteristika tjera dëshirojnë të përfshijnë në imazhin e vendit të tyre të shfaqur para botës. Një orë duhet majtur për diskutimin e fondeve.

Studimi dhe prezantimi në grupe: Praktikantët marrin përsipër një hulumtim të një shkalle jo fort të gjerë për të matur ndikimin e komunikimi masiv tradicional dhe atij bashkëkohorë (p.sh. komuniteti i radios: private, regjinale dhe gazeta ndërkombëtare) tek pjesëmarrja e audiences në debate sociale, politike dhe regjinale. Në vecanti, është e rëndësishme të fokusohen në rolin e telefonave dhe aplikacioneve të rrjeteve sociale (p.sh. Facebook and Tëitter) si mjete përgatitore grupore. Si tërësi, praktikantët duhet diskutojnë: Kush ka në pronësi medianë? Kush e bën mesazhin dhe cili është mesazhi kryesor që duhet përcjell? Çfarë audience kanë në shënjestër dhe pse? Kush i sponzorizon dhe çfarë mund të kishin bërë ndryshe? Si ndryshojnë mediat online dhe ato tradicionale?

Diskutime në klasë: Mësuesi duhet të udhëheq diskutimet në klasë në fushat kryesore të praktikantëve : interneti, teknologjia mobile (p.sh. SMS dhe aplikacionet smart të telefonave), TV, radio elektronike, lojëra kompjuterike (p.sh lojëra virtuale që krijojnë ndjesinë e të qenurit të vëerteta, sikur SIMS). Diskutimi ka për qëllim të eksploroj përparësitë dhe mangësitë e mediasë bashkëkohore (të re). Përpara këtij aktiviteti

praktikantët bëjnë intervista në komunitete rurale dhe urbane, në lidhje me përdorimin e telefonavë. Nga këto intervista, ata duhet të bëjnë prezantim se si përdoruesit e telefonave mobil kanë ndikim në jetën politike, ekonomike dhe sociale.

## — AKTIVITETET

- Bëjeni një hulumtim të shkallës jo fort të gjerë në temën sesi media dhe teknologjia e re po ndryshojnë mënyren e komunikimit në shoqëri, interaksionin mes njerëzve, shkëmbimin e informacioneve dhe kumptimin e vendimmarrjes.

- Bëni një studim social sesi mjetet e komunikimit masiv dhe teknologjia e re përdoren për komunikim dhe si ndikojnë përditshmërinë tonë, vlerat dhe mendimet e publikut. Për shembull si ka arritë teknologjia e telefonavë të bashkojë shtresën e lartë me atë të ulët? Eksploronini rreth asaj sesi komunikimi elektronik po ndryshon mënyren e ndërveprimit (interaksionit) social dhe shkëmbimit të informacioneve?

- Krijoni strategji në promovimin e interaksionit duke përdorur rrjetet sociale në një temë që ju zgjedhni. Cilat janë rreziqet dhe sfidat që zakonisht mësuesit përballen kur përdorin një temë të caktuar? Identifikoni rreziqet dhe jepni sugjerime si të zvogëlojnë ndikimin e tyre.

- Qeverisja elektronike përfshinë forma të reja qeverisjeje në të cilën ka ndikim të madh TIK. Përdorimi i TIK ka ndikuar në qeverisje në mënyra të ndryshme:

(1) Demokracia elektronike e cila lehtëson përfshirjen nëpërmes qasjes më të madhe ndaj informacioneve e në këtë mënyrë krijonë format bazike të vendimmarrjes; (2) Shërbimet elektronike po lehtësojnë punët e lodhshme sic janë mbushja e formës së taksës, të kontrollojë statusin e aplikacioneve dhe (3) Administrata elektronike po përmirëson proceset e punës brenda sektorit publik me ekzekutimin e proceseve TIK. TIK është shumë e dobishme në përmirësimin e proceseve të qeverisjes. Qeverisja elektronike dhe qeveria elektronike janë koncepte pothuajse të njëjta por me një dallim të vogël. Kjo e fundit i referohet sistemi në të cilën proceset qeveritare janë automatizuar përderisa e para merret me proceset gjithëpërfshirëse.

(cf. UNESCO 2007).

- Mësuesit të përdorin internetin për të kërkuar se në çfarë mase qeverisja elektronike është e pranishme në vendin tuaj. Duhet zgjedhin dy shembuj çfarëdo si dëshmi që këto aktivitete bëhen. Mësuesit duhet të tregojnë në çfarë mase janë përfshi në proces. A janë konsultu edhe me qytetarët? Diskutoni efektet e këtyre projekteve të qeverisjes elektronike. Cilat janë përparësitë dhe mangësitë? Bëni një hulumtim në projekte të ngjajshme në lidhje me qeverisjen lokale tek regjioni juaj ose jashtë tij. Çfarë lloj qeverisje elektronike do e rekomandonit në qeverisjen lokale? Pse?

- Aksesit në teknologjinë e re dhe TIK është e barasvlefshme me fuqizimin e burrave, grave, personave me aftësi të kufizuara dhe grupeve tjera të dalluara si ato etnike ashtu edhe popullata vendase që jetojnë në periferi.

- Përdorimi i burimeve vendore ose ndërkombëtare bën një hulumtim bazë mbi qasjen e grave, personave me aftësi të kufizuara dhe njerëzve që jetojnë në komunitetet e largëta për TIK ose teknologji të reja. A janë gratë e barabarta me burrat? Deri në çfarë mase personat me aftësi të kufizuara ose njerëzit që jetojnë në periferi kanë akses? Cilat janë implikimet? Çfarë duhet të bëhet nëse disa grupe janë të privuara nga qasja në teknologji të reja? Nëse këto të dhëna për vendin ose rajonin tuaj nuk gjenden, përpunoni të kuptoni arsyen? Cilat organizata duhet të merren me mungesën e këtyre të dhënave? Çfarë mundet të bëhet për këtë



# NJËSIA 3: PËRDORIMI INTERAKTIV I MJETEVE MULTIMEDIALE, PËRFSHIRE LOJËRAT DIXHITALE NË KLASA

► Kohëzgjatja: 3 orë

## TEMAT KRYESORE

- Mjetet interaktive multimediale, burime të hapura edukative, dhe lloje të zgjedhura të softuerit që mundësojnë edukimin
- Mjetet interaktive multimediale/lojërat dixhitale për të krijuar mjedise shoqërore-për të nxënë.
- Lojërat në media si mjet për të ndërgjegjësuar dhe për të shfaqur çështjet globale.
- Lojërat edukative kundrejt lojrave për argëtim

## OBJEKTIVAT E TË MËSUARIT

Pas përfundimit të kësaj njësie, mësuesit duhet të jenë në gjendje të:

- Identifikojnë vlerën e mjeteve interaktive multimediale, përfshirë ëbsite interaktive, prezantimet, diskutimet online, bllogjet, ëiki, libri-ëiki, e-libri, podcast(incizim i ndonjë pjese ku paraqitet vetëm zëri) videokasting(këtu edhe ka pamje vizuale) dhe lojërat e dhënies mësim dhe nxënies.
- Zhvillojnë aftësi intelektuale, shoqërore dhe menagjimin e vendit dhe kohës njëkohësisht, duke përdorur mediat interaktive, në vecanti lojërat
- Aplikojnë mjete interaktive mediale, vecanërisht lojërat dixhitale për të mësuar(të tjerët) dhe të nxënit
- Të përdorin mjete të ulëta/larta interaktive mediale/ lojërat përfshijnë koncepte nga lëndët akademike(p,sh.Matematika, shkenca, shkencat shoqërore etj.)
- Analizojnë mjete multimediale të ndryshme interaktive të krijuara nga përdorimi i burimeve të hapura ose edhe softuereve të pronësuar dhe të masin ndikim e tyre në mësim

## QASJA PEDAGOGJIKE DHE AKTIVITETET

Mjetet interaktive multimediale: Mendo për lëndën që u mëson. Përdorëni çfardo lloj mjeti hulumtues, identifikoni dhe listoni mjetet multimediale interaktive, përfshirë lojërat dixhitale, që mund të përdoren në një mësim specifik(ose mësim) tek grupi i mësuesve. Duhet identifikuar numrin e mjeteve të tilla. Bëji prioritet këto mjete në dobinë e nevojave specifike. Cfarë kriteresh ke? Hulumto për kritere bazuar në ekspertët e përdorimit të mjeteve edukative interaktive multimediale. Tani krahasojini kriteret tuaja me ato të ekspertëve. Cfarë po vreni? A po pajtoheni me kriteret e ekspertëve?

Në listën tuaj të mjeteve multimediale interaktive, mund të identifikoni mjetet që dukshëm ndryshojnë dhe lehtësojnë bashkëpunimin dhe diskutimin në procesin e mësimdhënies /të nxënit? Pse e bëri zgjidhni këto mjete? Si mendoni që teknologjia multimediale do tu mundësojë studentëve dhe mësuesver të ndryshojnë dhe krijojnë informacionin e tyre në mënyra të ndryshme?

Lojëra online:<sup>6</sup> Lojërat njerëzore stimuloese si janë paqeruajtësi, forca e ushqimit ose Darfuri po vdes. Si mund të të ndihmojë një lojë kompjuterike të mendosh në mënyrë kreative për çështjet globale? Cilat janë rezultatet mësimore nga këto lojëra? Nëse nuk ka

qasje ose qasje të kufizuar në internetin e institucioneve arsimore, mësuesit duhet të gjejnë material nga burime të tjera publike të internetit. Aty ku qasja në internet është tejet e kufizuar, mësuesi mund të përpiqet të marrë lojërat në formatin CD-ROM /DVD, ose të përdorë lojëra që janë te instaluar në kompjuterë. Trajnerët duhet që të

- Studioni rastet e lojrave elektronike në lëndë specifike (p.sh. gjuhë, matematikë, gjeografi, etj.) pilotoni përdorimin e lojrave në ndonjë kontekst të vecantë mësuesor. Shkruani një raport se si është përdorur loja dhe se si ka ndihmuar në arritjen e objektivave mësuesore

- Zhvilloni një plan mësuesor duke përdorur një lojë elektronike si pjesë e mësimit dhe të nxënies, për të ngritur ndërgjegjësim rreth çështjeve globale, sic janë uria, konflikti dhe paqja. Ligjeroni këtë mësuesor dhe shkruani një raport të shkurtër mbi përgjigjet e mësuesve, duke vënë në dukje pyetjet që ata ngritën dhe si kanë ndihmuar lojrat për t'i adresuar ato probleme

Burimet arsimore të hapura (OERs): Burimet arsimore të hapura (OERs ang.) materialet dhe mjetet - duke përfshirë kurset e plotë, modulet, materialet e kursit, tekstet shkollore, video, teste, softuer dhe materiale tjera (interaktiv ose jo-interaktiv), ose teknika - përdoren për qasjen në informacione, dokumente të hapura, me licencë të hapur, duke lejuar përdorimin e lirë, ri-përdorimin dhe përshtatjen për nevojat specifike (p.sh. nxëniesit, trajnerët e trajnerëve, lehtësuesit, etj.).

Trajnerët duhet të jenë të inkurajuar të:

- Identifikojnë disa faqe interneti që ofrojnë qasje në burime të hapura arsimore
- Identifikojnë kërkesat / kriteret për burimet e arsimit që do të përdoren si OERs
- Analizojnë se si OER janë krijuar, përdorur, shpërndarë dhe përshtatur për mësimit specifike dhe mjedise e nevojat të mësimit

- Analizojnë se si, për shembull, lojërat elektronike mund të shndërrohen në një OER, dhe të kuptojnë çfarë duhet bërë për të përmbushur kërkesat e OER, duke përfshirë të drejtat autoriale.

Hulumtimi i bibliotekës dhe diskutimi në klasë: Të trajnuarit duhet të identifikojnë, analizojnë dhe kritikojnë me një sërë teknikash të përdorura në lojërat elektronike. Kontrast lojra elektronike me lojëra tradicionale ose kulturore specifike për vlerat e tyre arsimore dhe kufizimet. Të trajnuarit duhet të paraqesin rezultatet e tyre përmes prezantimeve në PowerPoint ose të përdorin grafikët për të shfaqur rezultatet e tyre.

Diskutim në klasë: Bëni një plan mësuesor dhe futni dhe aktivitete të thjeshta mësuesore, duke përfshirë edhe mjetet multimediale interaktive ose lojërat elektronike në procesin e mësimit dhe të nxënies. Të trajnuarit duhet të shqyrtojnë të mirat dhe mangësitë e futjes të lojrave elektronike në mësimit. Një grup duhet të paraqesë përparësitë dhe grupi tjetër sfidat dhe mangësitë e përdorimit të lojrave elektronike në mësimit dhe të nxënies.

(Shih Kapitullin 3

të [http://ames.eun.org/2009/09/teachers\\_handbook\\_on\\_hoë\\_to\\_us.html](http://ames.eun.org/2009/09/teachers_handbook_on_hoë_to_us.html) për më shumë detaje.)

## BURIMET PER KETE MODUL

Ju lutem vini re se këto janë kryesisht shembuj të SHBA-ve të përfshira vetëm për qëllime ilustruese. Trajnuesit të identifikojnë burimet relevante lokale dhe rajonale kudo që të jetë e mundur.

- *Youth Protection Toolkit*, [www.yprt.eu](http://www.yprt.eu)

- Lenhart, A. 2009. *Është Personale: Ngjashmëritë dhe Dallimet në mes adoleshentëve dhe të rriturve në përdorimin e rrjeteve sociale. Adoleshentët, RrjetinSocial, Prezantimet e Gjeneratave në Takimin Vjetor të Shoqatës së Komunikimeve Ndërkombëtare (May 2009).*

[www.pewInternet.org/Presentations/2009/19-Similarities-and-Differences-in-Online-Social-Network-Use.aspx](http://www.pewInternet.org/Presentations/2009/19-Similarities-and-Differences-in-Online-Social-Network-Use.aspx)

- Madden, M. 2009. *Ngrënia, Mendimi dhe Qëndrimi Aktiv me Median Bashkëkohore. Shëndeti, Edukimi, Adolehenca, Familjet, Prezantimi i Web 2.0 presentation at the National Institute of Child Health and Human Development. (June 2009).*

[www.pewInternet.org/Presentations/2009/15--](http://www.pewInternet.org/Presentations/2009/15--)

[Eating-Thinking-and-Staying-Active-with-New-Media.aspx](http://www.pewInternet.org/Presentations/2009/15--Eating-Thinking-and-Staying-Active-with-New-Media.aspx)



# MODULI 7: MUNDESITE E INTERNETIT DHE SFIDAT

## HISTORIKU DHE SHPJEGIMI

Pjesëmarrja e qytetarëve në informim nga të gjitha grupmoshat është thelbësore për shoqërinë . Interneti ofron mundësi të mëdha për të përmirësuar jetën për të gjithë përdoruesit. Ajo ka efekte pozitive në arsim, në punë dhe në rritjen ekonomike. Me digjitalizimin, grumbullimin e informacionit dhe qasjen përmes një game të gjerë pajisjesh, interneti ka rritur jashtëzakonisht kapacitetin e ofrimit te burimit informativ për njerëzit. Fëmijët dhe të rinjtë shpesh i njohin shumë mirë aplikacionet e internetit dhe mund të përfitojnë jashtëzakonisht shumë nga përdorimi i tij, por edhe janë të pambrojtur. Rreziqet dhe kërcënimet shoqërojnë këtë zhvillim pozitiv, shpesh në mënyrë të njejte me ata që edhe ashtu jetojnë në botën offline.

Marrja e masave për mbrojtjen e të miturve mund të ndihmojë në zgjidhjen e problemit. Sidoqoftë, sado të dobishme të jenë këto masa ,edhe duke u mbështetur plotësisht në këto mënyra të mbrojes, nuk kanë rezultuar pozitivisht në ndërgjegjësim të përdorimit të tij. Mënyra më e mirë për t'i ndihmuar ata të qëndrojnë larg rrezikut është t'i fuqizojë dhe edukojë ata se si të shmangen ose të menaxhojnë rreziqet që lidhen me përdorimin e internetit. Teknologjia mund të luaj një rol të rëndësishëm dhe mbështetës në këtë fushë, veçanërisht kur fëmijët dhe të rinjtë përballen me probleme.

### NJËSITË

1. Të rinjtë në botën virtuale
2. Sfidat dhe rreziqet

# NJËSIA 1: TË RINJTË NË BOTËN VIRTUALE

► Kohëzgjatja: 3 orë

## TEMAT KRYESORE

- web 2.0 dhe bota virtuale
- Përdorimi i internetit dhe rutina(zakonet)? të fëmijëve dhe të rinjve
- Konventat ndërkombëtare dhe instrumente të tjera që kanë të bëjnë me të drejtat e fëmijëve

## OBJEKTIVAT E TË MËSUARIT

Pas përfundimit të kësaj njësie, mësuesit duhet të jenë në gjendje të:

- Kuptojnë përdorimin e modeleve dhe interesat në lidhje me internetin
- Përshkruajnë termat dhe kushtet e përgjithshme, kodet e sjelljes dhe rregulloret e privatësisë që ka të bëjë me përdorimin e internetit
- Zhvillojnë aftësinë e tyre për të përdorur metodat edukative dhe mjetet themelore për të ndihmuar të rinjtë të përdorin internetin në mënyrë të ndërgjeshme - dhe i bëjnë ata të vetëdijshëm për mundësitë, sfidat dhe rreziqet

## QASJET PEDAGOGJIKE DHE AKTIVITETET

Web 2.0 është një shkurtesë për aspektet e internetit që lehtësojnë ndërveprimin dhe përmbajtjen e krijuar nga përdoruesit (siç janë aplikacionet e telefonit celular).

Kjo njësi mund të mësohet duke përdorur burimet që mund të gjeni në internet, si p.sh. video-ku s'kërkohen e drejta e autorit dhe tiparet e tij ndikues çdo herë e po zgjerohen. Përndryshe, mund të përgatishni një prezantim të shkurtër në PowerPoint në Web 2.0. Ajo duhet të përfshijë sa më shumë elemente të jetë e mundur të botës virtuale. Organizoni diskutime në grupe të vogla për këto elemente. Kërkoni nga secili grup që të përgatitet dhe të japë një prezantim të shkurtër mbi përparësitë e Web 2.0.

- Pyetni mësuesit nëse janë përdorues të rrjeteve sociale ose të ëeb-it, dhe nëse po, sa shpesh. Kërkojuni atyre të shfletojnë ëeb-in, të krijojnë një profil, të shikojnë profilet e të tjerëve, të ngarkojnë dhe shkarkojnë përmbajtjen nga platformat e internetit (p.sh. Ëikipedia), dhe të marrin pjesë në dhomat e bisedave, bashkëpunimin në internet, blogjet dhe tëitter. Në diskutim me pjesëmarrësit pas këtij aktiviteti ata duhet të përqendrohet në përfitimet arsimore dhe përdorimin e ndërgjegjshëm të uebit, si dhe sfidat dhe rreziqet e tij. Shkruani dhe diskutoni disa nga shqetësimet tuaja personale kur përdorni web.

- Të trajnuarit hartojnë dhe përdorin një ëiki ne grupe për të shkëmbyer informacione rreth ndonjë aspekti të praktikës apo rregullave të arsimit. Për këtë detyrë duhet ndarë kohë të mjaftueshme për ta përfunduar, (p.sh. përgjatë një afati ku kryhet një lënd). Tutorët dhetë trajnuarit duhet të vendosin kritere për vlerësimin e efikasitetit, përshtatshmërisë dhe ndikimit të ëiki-ve në trajnimin e pjesëmarrësve

- Kërkoni nga mësuesit që të organizohen në grupe të vogla. Secili grup duhet të diskutojë dhe listoj të paktën pesë aktivitete kryesore që mendojnë se të rinjtë i kryejnë në internet. Kërkoni të rendisin rëndësinë e këtyre aktiviteteve në një shkallë prej 1 deri në 5. Secili grup duhet paraqes rezultatet e diskutimeve të tyre, duke shpjeguar se si janë organizuar dhe çfarë ka ndikuar në vendimet që kanë marrë. Trajnuesiduhet të prezantojë

statistikat aktuale (të përgatitur paraprakisht dhe bazuar në burimet ekzistuese) rreth përdorimit të internetit nga fëmijët, nëse ka statistika të tilla. Krahasoni rezultatet e punës në grup me atë që statistikave aktuale paraqesin. Diskutoni. A ka të papritura? A ka statistika në lidhje me përdorimin e internetit specifikisht për rajonin ose vendin tuaj? Nëse jo, çfarë nënkuptohet? Diskutoni se çfarë mund të bëhet për mungesën e statistikave të tilla

- Diskutoni masën në të cilën të rinjtë e përdorin internetin për qëllime arsimore, duke shikuar lajme, duke marrë pjesë në procesin politik të vendit të tyre, duke mësuar më shumë dhe bashkëveprimi me njerëz nga kultura të ndryshme, etj. A ka indikacione të përdorimit në shkallë të lartë? Çfarë mund të bëhet për të motivuar të rinjtë të përdorin internetin pozitivisht? Pyetni mësuesit (në grupe të vogla ose individualisht) të përgatisin një mesim të shkurtër që ka të bëjë me lëndën e tyre, duke përfshi përdorimin e Internetit në mesim. Të mësuarit duhet tregojnë jo vetëm se si objektivat e mesimit mund të arrihen përmes përdorimit të Internet, por gjithashtu se si mësuesi mund t'i motivojë studentët.

- Diskutoni me mësuesit mbi termat e ndryshëm të internetit dhe kushtet e përgjithshme, kodet e sjelljes dhe rregulloret e privatësisë. Pastaj nxisni ata që të zhvillojnë një model 130 në kodin e sjelljes, duke u fokusuar në përdorimin e internetit nga fëmijët dhe të rinjtë

- Analizoni sjelljen e fëmijëve dhe profilet e tyre online: Të trajnuarit që punojnë në grupe hulumtojnë përdorimin e internetit të fëmijëve në moshë 6-17 vjeç. Raportet e grupeve duhet të theksojnë sa është i përhapur përdorimi i internetit dhe për çfarë fëmijët e përdorin atë, pastaj krahasojeni me atë që prindërit thonë për përdorimin e internetit nga fëmijët. Cilat janë mundësitë dhe sfidat që paraqet interneti për fëmijët dhe prindërit?

- Organizoni një diskutim rreth një kauze në Deklaratën e të Drejtave të Njeriut, të Konventës së Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Fëmijës, ose në instrumente të tjera ligjore përkatëse në vendin ose rajonin tuaj që lidhet me përdorimin e internetit dhe të rinjtë -e drejta për informim, liria e shprehjes, mbrojtja e të miturve dhe roli i prindërve, qeverive dhe shoqërisë civile. Diskutoni këto çështje individualisht dhe më pas shikoni si janë të lidhura. A bien ndesh liria e shprehjes me të drejtën e qasjes në informacion? A janë të dyjat të nevojshme? A duhet liria e shprehjes dhe e drejta e qasjes në informata sakrifikuar për hir të mbrojtjes? Pse po pse jo? A duhet vajzat dhe djemtë të kenë akses të barabartë në informacion, internet dhe teknologji të reja? Çka po ndodh në rajonin tuaj? Si mund të trajtohet kjo? Kërkojuni mësuesve të përgatiten një poemë të shkurtër mbi liritë dhe të drejtat e për të mbrojtur të miturit

## NJËSIA 2: SFIDAT DHE RREZIQET NË BOTËN VIRTUALE

► KOHËZGJATJA: 3 orë

## TEMAT KRYESORE

- Të kuptuarit e sfidave dhe rreziqeve të përdorimit të internetit
- Fuqizimi dhe përdorimi i përgjegjshëm i internetit
- Privatësia dhe siguria

## OBJEKTIVAT E TË MËSUARIT

Pas përfundimit të kësaj njësie, mësuesit duhet të jenë në gjendje të:

- Listojnë dhe përshkruajnë sfidat / rreziqet e përdorimit të internetit dhe ku kanë më shumë gjasa të ndodhin
- Zhvillojnë njohuri rreth rreziqeve dhe kërcënimeve që potencialisht shoqërojnë zhvillimet e reja
- Kuptojnë ndërvarësitë midis sjelljes së përdoruesve dhe gjasave për të qenë viktimë ose kryerës.
- Zbatoni këto njohuri për tu'a mundësuar mësuesve përdorimin e internetin më me përgjegjësi

## QASJA PEDAGOGJIKE dhe AKTIVITETET

Sfidat dhe rreziqet që kanë të bëjnë me përmbajtjen online

Adaptuar nga *Youth Protection Roundtable Tool Kit - Stiftung Digitale Chancen 2009*

**Përmbajtja e papërshtatshme për moshën:** Interneti ofron përmbajtje të pasur për të gjitha grupet e përdoruesve. Ofrohen shërbime edhe për interesa të përgjithshëm edhe për ata më të vecantë. Megjithatë, jo cdo përmbajtjen duhet të jetë e qasshme për fëmijët dhe të rinjtë. Pra, duhet të vendoset me kujdes se cila përmbajtje është e përshtatshme për të cilat grupmosha. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet përmbajtjes që nuk është e paligjshme në përgjithësi por mund të dëmtojë përdoruesit e rinj. Përmbajtja jo-e përshtatshme si pornografia mundet të dëmtojë sidomos fëmijët e vegjël kur i ekspozohen pa qëllim. Rreziku i përballjes me përmbajtjen e papërshtatshme për atë moshë mund të rezultojë nga sjellja e vetë përdoruesit kur me qëllim e kërkon, si dhe hasja në to pa ndonjë qëllim. Përmbajtja që nuk është e përshtatshme për të gjitha grupmoshat mund të shfaqet për arsye komerciale, por mund të krijohen edhe nga vetë përdoruesit. Qasja në të parën mund të jetë kufizuar vetëm për grupet e përdoruesve të mbyllur, ndërsa përmbajtja e krijuar nga përdoruesit është kryesisht në dispozicion të publikut dhe prandaj ka nevojë për vëmendje të veçantë. Që sot shumë fëmijë dhe të rinj kanë telefona celular me funksione multimediale dhe qasje në internet pa u munduar, duhet kihet parasysh që ata mund të kenë qasje në përmbajtje të papërshtatshme për moshën kur janë vetë dhe që nuk mbikqyren nga të rriturit. Pajisjet mobile gjithashtu u mundësojnë fëmijëve të prodhojnë përmbajtjen e vet digjitale në çdo situatë të jetës, duke kontribuar kështu në rritjen e vëllimit të përmbajtjes së krijuar nga përdoruesit.

**Përmbajtja e paligjshme (p.sh. racizmi dhe pornografia e fëmijëve):** Lloji i përmbajtjes së klasifikuar si ilegal varet më së shumti nga ligjet e vendit, edhe pse disa lloj përmbajtjesh janë të jashtëligjshme në shumicën e vendeve. Sidoqoftë, përmbajtja e paligjshme është e qasshme dhe mund të arrihet pa dashje ose qëllimisht nga fëmijët dhe të rinjtë. Kujdes

duhet t'i kushtohet gjithashtu fëmijëve dhe të rinjve si viktime potenciale të përmbajtjes ilegale, p.sh. duke marrë dhe botuar fotografi ose video të abuzimit të fëmijëve.

**Mungesa e verifikimit të përmbajtjes:** Duke pasur parasysh se përmbajtja e qasshme përmes internetit shpesh nuk është verifikuar nga një burim i pavarur, është e rëndësishme që të rinjtë të mësojnë të lexojnë përmbajtjen me një sy kritikë dhe mos marrin gjithçka si të kryer. Përmbajtja e krijuar nga përdoruesi, shpesh mund të jetë i pjesshëm, i njëanshëm ose i pasaktë. Përdoruesit më të vegjël duhet të jenë të vetëdijshëm për rreziqet e të besuarit çdo gjë-je që lexojnë në internet.

**Nxitja e dëmit:** Ka shumë faqe në internet që nxisin përdoruesit të dëmtojnë veten (p.sh. faqet e internetit që promovojnë vetëvrasje, anorexia apo sektarizëm). Me Eeb 2.0 ekzistonë mundësia e publikimit të përmbajtjes së vetë përdoruesit, rreziku i ekspozimit ndaj nxitjes së dëmtimeve është në rritje. Në veçanti fëmijët dhe të rinjtë në shumë raste nuk janë në gjendje të bëjnë një vlerësim real të rreziqeve që rrjedhin nga ndjekja e udhëzimeve të dhëna në faqet e internetit të tilla. Shkelja e të drejtave të njeriut / shpifja: Në anonimitetin e internetit, propaganda kundër grupeve të caktuara popullsië ose individëve mund të jenë lehtësisht të përhapura.

Shkelja e të drejtave të njeriut / shpifja: Në anonimitetin e internetit, propaganda kundër

grupe të caktuara popullsië ose individë mund të jenë lehtësisht të përhapura. Përveç kësaj, mund të supozohet që njerëzit të veprojnë në mënyrë të ndryshme në internet kur nuk duhet të përballen direkt me homologët ose viktimat e tyre dhe prandaj nuk ballafaqohen menjëherë me pasojat e sjelljes së tyre. Kështu rreziku i shkeljes së të drejtave të njeriut dhe të qenit viktimë e shpifjes ka shumë më tepër të ngjarë në internet se sa në realitet. Gjithashtu, përmbajtja shpifëse është e dëmshme për fëmijët dhe të rinjtë mendimi i të cilëve mund të ndikohet nga informata mashtruese

**Reklamimi dhe marketingu i papërshtatshëm për fëmijët:** Reklamimi i papërshtatshëm do të thotë rreziqet e pranimit ose të ekspozimit ndaj reklamave për produktet ose shërbimet që janë të papërshtatshme për fëmijët, sic kirurgjia kozmetike. Përdoruesit japin informacione prersonale (dmth. emri, moshë ose gjinia), dhe ka më shumë gjasa që atyre tu shfaqen reklama ose tu kërkohet të marrin pjesë në llotari. Pasi që fëmijët në shumë raste nuk janë të vetëdijshëm për pasojat e dhënies së emrave të tyre në forma dhe kuti në internet, ata janë në rrezik. Duke marrë parasysh shkallën e lartë të mundësisë së depërtimit tek telefonat të fëmijëve dhe të rinjve, vëmendja duhet t'i kushtohet këtij kanali shtesë për përhapjen e reklamave.

**Privatësia:** Sapo të publikohet në ueb, përmbajtja mund të përhapet me shpejtësi në mbarë botën dhe të mbetet në ekzistencë një kohë të pacaktuar. Përdoruesit, dhe në veçanti fëmijët dhe të rinjtë, shpesh nuk janë të vetëdijshëm për pasojat afatshkurtra dhe afatgjata të publikimit të teksteve dhe fotove që ata nuk duan të bëjnë publike më vonë. Të dhënat e ruajtura në një server ose platformë mund të arrihen lehtësisht nga të tjerët dhe njerëzit nuk mund të jenë të vetëdijshëm se sa të pambrojtur mund të jenë të dhënat e tyre personale. Është e rëndësishme kur përdorni internetin që njerëzit të kuptojnë plotësisht mjedisin në të cilin po punojnë. Shkelja e të drejtës së autorit: C.

Shkelje e të drejtave të autorit: Shkelja e të drejtës së autorit është një rrezik kryesisht i lidhur me sjelljen e vetë përdoruesve. Pavarësisht nëse një e drejtë autori është shkelur qëllimisht ose aksidentalisht, shkelja shihet si mashtrim nga mbajtësi dhe e vendos shkelësin në rrezik të dënim

Rreziqet që lidhen me kontaktin online

Përshtatur nga *Mbrojtja e Rinisë së Tabelës së Kutisë së Ndhmës - Stiftung Digitale Chancen 2009*

Këshillat e dëmshme: Forumet, blogjet dhe fushat e tjera të kontaktit të internetit ofrojnë



një platformë për shkëmbimin e informacionit dhe këshillave midis përdoruesve. Kjo mund të jetë e dobishme, por gjithashtu mund tu mundesoj kontaktin me persona të rrezikshëm ose edhe shumë të dëmshëm. Rreziku i marrjes së këshillave të dëmshme, në veçanti për fëmijët dhe të rinjtë, është më e madhe në platformat e komunitetit social ose në aplikacione të tjera të Eeb 2.0 sesa në faqet e internetit të rregullta.

Vjedhja e identitetit: Marrja dhe përdorimi i identitetit elektronik të të tjerëve (p.sh., emri i përdoruesit dhe fjalëkalimi) me qëllimin për të kryer mashtrime tregtare ose të tjera dhe për të përfituar nga ajo quhet vjedhje e identitetit. Vjedhja e identitetit është një rrezik në rritje pasi numri i identiteteve virtuale po rritet me numrin e njerëzve në internet dhe veçanërisht ata që përdorin shërbime të personalizuar.

Vjedhje e parave / phishing: Phishing i referohet procesit të vjedhjes së detajeve bankare, në veçanti numrave identifikues personal (PIN) dhe numrave të vërtetimit të transaksionit (TAN), me qëllim që të grabisin llogaritë bankare të njerëzve të tjerë. Të rinjtë kanë më shumë gjasa të mos mund të indentifikojnë një faqe interneti të rreme dhe të japin detajet e tyre bankare.

**Mashtrimet komerciale:** Mashtrimet tregtare ndodhin kur shitësit pretendojnë të shesin mallra ose shërbime të cilat, pas pagesës, ose nuk kanë karakteristikat e premtuara ose nuk dorëzohen fare. Mund të rezultojë gjithashtu nëse identifikon vjedhjen ose phishing. Një burim tjetër mashtrimi tregtar mund të jetë shitja e shërbimeve digjitale (p.sh. tingull i telefonit) me një çmim të paarsyeshëm dhe të padrejtë, shpesh të lidhur me një nënshkrim që nuk ishte e menduar mire nga blerësi. Në shumicën e rasteve, përdoruesit (dhe në veçanti të rinjtë) njerëzit dhe fëmijët) nuk janë në dijeni të pasojave të kontratave të tilla të lidhura në internet.

Prekja: Prekja (grooming ang.) i referohet pedofilëve duke përdorur internetin si një mjet për të kontaktuar fëmijët dhe të rinjtë, duke fshehur identitetin e tyre të rritur. Ata shpesh me strategji arrijnë qëllimin e tyre duke plotësuar dëshirën e fëmijëve për miqësi dhe familjaritet. Të gjitha fushat e internetit që ofrojnë platforma për kontakt personal dhe shkëmbimi ka të ngjarë të ofrojë një bazë për sulmet e grooming. Siç u përmend edhe më parë, telefoni celular (si një pajisje shtesë për të kontaktuar me të tjerët dhe për të hyrë në rrjetet sociale) duhet të merret në konsideratë këtu, sidomos kur fëmijët e shohin telefonin e tyre celular si një pjesë të veçantë të jetës së tyre private dhe që kryesisht janë vetëm kur përdorin atë. Kështu, me rritjen e teknologjisë së komunikimit mobil dhe rrjeteve sociale, rreziku për të rënë pre i një sulmi "joshës" nga pedofilët e pastaj pranimi i një ftese të rrezikshme është bërë shumë më i madhe.

Ngacmimi/Përqeshja: Llojet e ndryshme të ngacmimeve duket të jenë gjithmonë pjesë e jetës së njerëzve. Ngacmimi i njëri-tjetrit në internet është sigurisht më i thjeshtë për shkak të anonimitetit që mundësojnë mediat. Fëmijët dhe të rinjtë në veçanti rrezikojnë të jenë viktimat të ngacmimeve dhe dhunimeve. Prandaj ngacmimi lidhet me sjelljen e vet, si dhe sjelljen e të tjerëve. Edhe pse publikimi i fotove të montuara mund të jetë pjesë e ngacmimeve, ky fenomen kryesisht lidhet me kontaktet online. Siç u përmend më parë, telefonat celularë shumëfunksional përdoren shpesh për të marrë fotografi me qëllim të ngacmimit dhe pastaj publikimi i fotove në internet ose dërgimi i tyre përmes multimedia mesazheve (MMS) tek tjerët. Meqenëse shumë fëmijë dhe të rinj kanë një telefon celular të pajisur me një aparat fotografik dixhital, ngacmimi po bëhet më i lehtë.

Shpalosja e informacionit privat: Kur vendosni një profil në një platformë shoqërore, përdoruesit janë të ftuar të zbulojnë informacionin privat për t'u paraqitur në komunitet. Gjithashtu në dhomat e bisedave dhe në forumet përdoruesit mund t'i zbulojnë të dhënat private të tjerëve, siç janë adresa e tyre ose numri i telefonit. Të rinjtë në veçanti, nuk janë në gjendje të parashikojnë pasojat e publikimit të të dhënave të tyre private. Ata shpesh nuk janë në dijeni se një bisedë (në telefon/chat) nuk është private, por publike.

Profilizimi: Me rritjen e numrit të profileve që një person mund të publikojë në platforma të ndryshme, ekziston një rrezik më i madh që të dhënat personale të publikuara në një platformë do të shkrihen me të dhëna të publikuara në platforma të tjera ose të jepen diku tjetër (p.sh., në sondazhe ose llotari). Kështu krijohen profile që bëjnë të mundur

adresimin direkt të personit me përmbajtje, shërbime dhe reklama potencialisht të padëshiruara. Profilizimi mund të kryhet nga faqja e internetit ku të dhënat personale shfaqen publikisht, por një praktikë më e rrezikshme është kur profilet e përdoruesve (ose profilet e tyre të pjesshme) merren nga baza e të dhënave pas faqes së internetit. Është e rëndësishme të dimë se çfarë nënkuptohet me përmbajtje të dëmshme në internet. Ligji ndërkombëtar për të drejtat e njeriut përcakton një numër kufizimesh të pranueshme për lirinë e shprehje - veçanërisht kur liria e fjalës bie ndesh me të drejta të tjera. Shembujt problemeve që mund të kufizohen përfshijnë nxitjen ndaj dhunës ose urrejtjes racore, imazheve të seksit të fëmijëve dhe shpifjes. Në çdo rast, ligji ndërkombëtar përcakton që kufizimet duhet të jenë të hollësishme dhe të mbikëqyrura nga gjykatat

- Kërkojuni mësuesve të ndajnë ndonjë përvojë që ata ose një mik/mike janë përballur me ndonjë prej sfidave të përshkruara më lart. Si kanë vepruar? Cila ishte rezultati final? Çfarë mësimesh nxorrën?

Për shembull, vjedhja e identitetit, vjedhja monetare / phishing, shkelje e të drejtave të njeriut, shpifjet apo ndonjë abuzim tjetër në internet. Nëpërmjet kërkimit, ose duke përdorur burimet e ofruara në programin mësimor Edukimi mbi median the informacionin, të identifikojnë dhe listojnë hapat që duhet të ndërmerren dhe karakteristikat e sakta që mësuesit duhet të kenë parasysh në mënyrë që të dijë kur një informacion është mashtrim, dhe kur janë në kundërshtim me të drejtat e njeriut. Cilat janë disa nga përfitimet e elektronike bankare dhe komerciale? Burimet e përdorura për këtë aktivitet duhet të jenë praktike dhe të përfaqësojnë rastet reale sa më shumë që të jetë e mundur. Mësuesit mund ta kryejnë këtë aktivitet për të gjitha rreziqet e renditura më sipër

- Bëni një kërkim në internet sa ka informacione për mjekësinë (ose kategorive të tjera) në internet. Faqet e internetit mjekësore mund t'ju ndihmojnë të diagnostikoni ndonjë problem shëndetësor që ti ke? A është e sigurt për të ndërmarrë veprime në lidhje me shëndetin tuaj në bazë të këshillave nga interneti? Listoni dhe diskutoni mënyrat kryesore për të përcaktuar autenticitetin dhe autoritetin e mjekësisë

- Nëse jeni pjesë e rrjetit social, bëni një kërkim në Google emrin tuaj. Sa shumë informacione personale rreth jush është në dispozicion në domenin publik? Mund të gjeni akoma informacion rreth jush që keni fshirë nga rrjeti juaj social? Cila nga rreziqet e përmendura më lart është kjo lidhur me?

- Merrni një ekstrakt nga Deklarata e të Drejtave dhe Përgjegjësive të Facebook-ut, Neni 2.7 'Ndarja e përmbajtjes dhe informacionit' (ose nga ndonjë rrjet tjetër social ose në softuerin që vjen me kompjuterin tuaj). Në grupe të vogla, analizoni nëse ekstraktin që keni zgjedhur mund të ketë ndikim në privatësinë e dikujt dhe ndoshta në sigurinë e tij/saj. Si mund ta kontrollojnë përdoruesit përmbajtjen e postuar në internet? Analizoni dhe diskutoni se kush mban të drejtën e autorit për lloje të caktuara të përmbajtjes (foto, video, etj.) Të postuara në rrjetet sociale ose në internet

- Shqyrtoni Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës (<http://www.unicef.org/crc/>). Ajo përcakton të drejtat themelore të njeriut që fëmijët kudo kanë: e drejta për mbijetesë; të zhvillohet në mënyrë të plotë; për mbrojtjen nga ndikimet e dëmshme, abuzimi dhe shfrytëzimi; dhe të marrin pjesë plotësisht në jetën familjare, kulturore dhe shoqërore. janë ka artikuj Konventë që kërkojnë zhvillimin e udhëzimeve të duhura për mbrojtjen e fëmijëve nga informacioni dhe materiali që mund të dëmtojë mirëqenien e tyre?

- Sipas Raportit të Watch Teknologjisë të Bashkimit Ndërkombëtar të Telekomunikacionit 10, veprimet për të adresuar shqetësimet e privatësisë dhe sigurisë janë prioriteti numër një i përmirësimit të jetës në botën digjitale dhe asaj në internet (ITU 2009). Mungesa e sigurisë në mënyrë të pashmangshme paraqet një rrezik për të gjitha sistemet dhe proceset që mbështeten në elektronikën e komunikimit, përfshirë mediat (ITU 2006). Drejtësia e dobët (ose mungon) çon rastet në rritje të krimeve kibernetike. Ky kërcënim është aq serioz sa i përket Partneritetit Ndërkombëtar Shumëpalësh Kundër Kërcënimeve Kibernetike (IMPACT)

që u krijua për të promovuar bashkëpunimin ndërkombëtar, për të bërë hapësirën kibernetike më të sigurt. Dr Hamadoun Touré, ITU sekretari i përgjithshëm, thotë se "qasja në komunikim është e padobishme në qoftë se paqja dhe siguria online nuk mund të garantohet ...", dhe shton se ne duhet ta shohim botën dixhitale si një "komunitet", ku përdoruesit kane sakrifikuar lirin dhe anonimitetin për mbrojtje më të sigurt. (Lajmet ITU)

Megjithatë, shumë aktivistë për liri në Internet janë të shqetësuar për ndërhyrjen dhe kontrollin e qeverisë. Ekziston një shqetësim në rritje se interneti po bëhet një hapësirë e mbyllur e kontrolluar dhe jo një hapësirë e hapur për interes publik dhe gjithnjë e më shumë dominojnë qeveritë dhe korporatat. Mund të jetë që për disa qeveri dhe biznese, siguria është shqetësimi dominues, ndërkohë që ky nuk është rasti i njejtë për shumë qytetarë.

- Diskutoni deklaratat e mësipërme të bëra nga Dr Touré. A mendoni se qeveritë duhet të ndër marrin hapa për ta bërë botën virtuale më të sigurt? Pse ose pse jo?

- A pranoni që privatësia do të duhet të sakrifikohet deri në një farë mase? Cilat janë disa nga implikimet? Pse mendoni se nuk është e mundur apo e dëshirueshme të rregulloni internetin si televizion dhe radio? Çfarë do të ndodhte nëse Interneti do të kontrollohej nga ndonjë vend apo rajon i botës?

- Bëni një kërkim në disa (5-10) lloje të mjeteve që përdoren për sigurinë e internetit - bllokimin, filtrimin, kontrollet ligjore dhe kështu me radhë. Diskutoni për përfitimet dhe disavantazhet e tyre

- Zgjidhni çdo website ose softuer të rrjetit social që përdorni. Eksperimentoni me parametrat e privatësisë. Kërkoni në 'kushtet e përdorimit' për termat 'privatësi dhe siguri'. A mendoni se masat mbrojtëse të privatësisë janë të mjaftueshme për t'ju ndihmuar të shmangni disa nga rreziqet e përshkruara në këtë seksion (shih kutitë për rreziqet që kanë të bëjnë me përmbajtjen dhe kontaktin në internet)? Cilat janë disa nga pasojat kur vendosni parametrat e privatësisë në nivelin maksimal?

